



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 184/23

Nr. i fq. / Br. sht - 24 -

Data: / Datum 27. 07. 2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



**REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI**

**RREGULLORE
(KKV) NR.05/2023 PËR PUNËN E KUVENDIT**

Korrik, 2023

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4, në lidhje me nenin 40, paragrafi 2, shkronja “a” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 17, paragrafi 4 në lidhje me nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë nr.209/22, Kuvendi i Komunës, së Vushtrrisë në mbledhjen mbajtur më **27 korrik 2023** miraton këtë:

RREGULLORE PËR PUNËN E KUVENDIT

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

1. Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e organizimit dhe funksionimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, komiteteve obligative, konsultative, komisioneve dhe grupeve punuese të formuara nga kuvendi për ushtrim të kompetenceve dhe përgjegjësi të Kuvendit.
2. Kjo Rregullore përcakton të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit, udhëheqësve të grupeve kuvendare, rregullat e rendit dhe të mirësjelljes së anëtarëve të kuvendit, procedurat e pjesëmarrjes së qytetarëve në seancat e kuvendit, si dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.
3. Çështjet që nuk janë përfshirë në këtë rregullore e që lidhen me punën e kuvendit do të përcaktohen me vendim ose akt tjetër të kuvendit në pajtim me Statutin e Komunës dhe me LVL.
4. Kuvendi i komunës aktivitetin e tij e mbështet në planin vjetor të punës, duke përfshirë edhe aktivitetet tjera në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore.

Neni 2 Vulat e Kuvendit të Komunës

1. Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë e ka vulën e vet zyrtare.
2. Forma dhe përmbajtja e vulës së Kuvendit të Komunës përcaktohet me Ligjin Nr. 03/L-054 për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës.

Neni 3 Përkufizimet

2.1 Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:

2.1.1. “Ligj”, nënkupton Ligjin nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale,

- 2.1.2. “**Statut**”, nënkupton aktin më të lartë juridik të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë,
- 2.1.3. “**Kuvendi i komunës**”, nënkupton organin më të lartë përfaqësues të komunës i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejt nga qytetarët,
- 2.1.4. “**Kryesuesi/ja i/e Kuvendit**”, nënkupton kryesuesin e zgjedhur nga anëtarët e kuvendit të komunës;
- 2.1.5. “**Grup kuvendar**”, nënkupton grupin e anëtarëve të kuvendit prej tre ose më tepër anëtarë që e përfaqësojnë të njëjtin subjekt politik dhe koalicionet;
- 2.1.6. “**Anëtar i kuvendit**”, nënkupton anëtarin e zgjedhur drejtpërdrejt në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet Lokale;
- 2.1.7. “**Kryetar i Komunës**”, nënkupton kryetarin e zgjedhur drejtpërdrejt nga vota e qytetarit, në përputhje me ligjin në fuqi për zgjedhjet lokale;
- 2.1.8. “**Komitet**”, nënkupton komitetet e përhershme dhe komitetet tjera të themeluara nga kuvendi i komunës;
- 2.1.9. “**Kryesues i komitetit**”, nënkupton kryesuesin e zgjedhur nga anëtarët e komitetit, përveç kryesuesit të KPF-së të cilin me automatizëm e udhëheq kryesuesi i kuvendit;
- 2.1.10. “**Anëtar i komitetit**”, nënkupton anëtarët e komiteteve të kuvendit të komunës.
- 2.1.11. “**Komision**”, nënkupton anëtarët e komisionit;
- 2.1.12. “**Kryesues i komisionit**”, nënkupton kryesuesin e zgjedhur nga anëtarët e komisionit;
- 2.1.13. “**Drejtor**”, nënkupton drejtorët e emëruar nga Kryetari i Komunës;
- 2.1.14. “**Sekretaria e Kuvendit të Komunës**”, nënkupton zyrën për ofrimin e shërbimeve profesionale për Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë;
- 2.1.15. **Kartela identifikuese**, nënkupton dokumentin identifikues për anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë gjatë mandatit të tij/saj.

Neni 4 Kuvendi i Komunës

1. Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe anëtarët e tij zgjedhen në mënyrë të drejtpërdrejt nga qytetarët në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet Lokale.
2. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë përbëhet prej 35 (tridhjetë e pesë) anëtarëve.
3. Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim:

“Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nderë, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas Kushtetutës e Ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si këshilltarë i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, në mënyrë që të sigurohën kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

4. Anëtarët e Kuvendit të komunës të cilët/at nuk e nënshkruajnë betimin solemn ose mandatin brenda një (1) muaji pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, pushojnë të jenë anëtarë.

Neni 5 Mandati

1. Mandati i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 4 (katër) vite.
2. Mandati i çdo anëtari/es të Kuvendit të Komunës verifikohet nga komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga kuvendi i komunës, para nënshkrimit të mandatit nga secili anëtar.
3. Anëtari/ja i/e kuvendit të komunës pushon të jetë anëtar;
 - 3.1. Me rastin e përfundimit të mandatit të tij;
 - 3.2. Nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur;
 - 3.3. Nëse anëtari/ja ia paraqet kryesuesit/es të kuvendit dorëheqjen me shkrim nga posti i tij;
 - 3.4. Nëse anëtari/ja ka qenë i dënuar për ndonjë veprë penale dhe është lëshuar urdhëri për burgim për gjashtë ose më shumë muaj;
 - 3.5. Nëse anëtari/ja nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e kuvendit të komunës pa arsye;
 - 3.6. Nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm skualifikon apo e konsideron të papërzgjedhshëm.
4. Anëtari/ja i/e Kuvendit të Komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.
5. Anëtarët e kuvendit të komunës nuk kanë të drejtë që në të njëjtën kohë të jenë edhe pjesë e ekzekutivit të komunës në këto raste:
 - 5.1. Nënkryetar i Komunës;
 - 5.2. Drejtorë të drejtorive komunale;
 - 5.3. Drejtor të institucioneve edukativo arsimore dhe shëndetësore;
 - 5.4. Drejtor të ndërmarrjeve publike dhe zyrtarë të përcaktuar me nenin 21.3 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
 - 5.5. Nëpunës i Shërbimit Civil.

Neni 6 Konfliktet e interesit

1. Anëtari/ja i/e kuvendit të komunës apo anëtari/ja i/e komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material.

2. Çdo anëtar duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është prezent. Çdo këshilltar mund të ofrojë informacione për interesat e anëtarit tjetër.
3. Para mbledhjes së parë të kuvendit të komunës, anëtarët e kuvendit duhet t'i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare në një regjistër publik të cilin e mbanë shefi i administratës dhe personelit. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin.
4. Kryesuesi/ja obligohet të kërkojë nga anëtari/ja i/e kuvendit që ta lirojë sallën e mbledhjes gjatë procedurës së vendimmarrjes lidhur me çështjen për të cilën anëtari/ja i kuvendit ka konflikt interesi.
5. Anëtarët e Kuvendit mbajnë përgjegjësi për mospërmbajtje dhe mospërfillje të dispozitave ligjore konform **Ligjit Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik**.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit

1. Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës kanë të drejta dhe mundësi të barabarta të marrin pjesë plotësisht në punimet e kuvendit. Kuvendi i komunës siguron që këto të drejta dhe mundësi të parashikohen në Statutin dhe në rregulloren e tij të punës.
2. Anëtari/ja i/e kuvendit të komunës ka të drejtë të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga kryetari. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e punës.
3. Anëtari/ja i/e kuvendit të komunës mund t'iu drejtohet të pranishmëve në cilindo komision të kuvendit të komunës anëtar i të cilit nuk është, por nuk mund të votojë. Ai apo ajo mund t'i propozojë kryesuesit/es të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është përgjegjësi e komitetit.
4. Anëtari/ja i/e kuvendit të komunës mund të kërkojë nga kryetari informacione që janë të nevojshme për punën e tij si këshilltar. Nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen, ai apo ajo mund ta ngrisë çështjen në kuvendin e komunës.
5. Anëtari/ja i/e kuvendit të komunës lejohet të mungojë nga vendi i punës për periudha kohore që janë të domosdoshme për kryerjen punëve të kuvendit .
6. Kuvendi i komunës, në pajtim me Statutin e komunës dhe me udhëzimet e nxjerra nga qeveria qendrore, i kompenson anëtarët e kuvendit për punën e tyre në kuvendin e komunës.
7. Anëtarët e kuvendit të komunës detyrohen të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e kuvendit, të thirrura në mënyrë të duhur në komisionet ku ata janë anëtarë, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të justifikueshme për mungesën e tyre.

Neni 8

Funksionimi i kuvendit të komunës

1. Kuvendi i komunës funksionon në bazë të ligjit, statutit dhe kësaj rregulloreje.
2. Kuvendi i komunës ushtron kompetencat e veta të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, rregulloret dhe udhëzimet administrative të miratuara nga Ministria e Pushtetit Lokal e që kanë të bëjnë me pushtetin lokal.
3. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë nuk mund të delegojë përgjegjësitë e saja lidhur me marrjen e vendimeve për:
 - 3.1. Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre,
 - 3.2. Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
 - 3.3. Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës;
 - 3.4. Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
 - 3.5. Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij Ligji;
 - 3.6. Zgjedhjen e Kryesuesit/es të Kuvendit të Komunës;
 - 3.7. Niveli i tarifave dhe ngarkesave;
 - 3.8. Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
 - 3.9. Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
 - 3.10. Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
 - 3.11. Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës;
 - 3.12. Përgjegjësitë të tjera që kërkohen me ligj.
4. Për marrjen e vendimeve, kuvendi i komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij Komitetit për Politikë e Financa apo kryetarit të komunës. Kuvendi mund ta tërheq delegimin në çdo kohë.

Neni 9

Mbledhjet e kuvendit të komunës

1. Kuvendi i Komunës mbanë:
 - 1.1. Mbledhje inauguruese;
 - 1.2. Mbledhje të rregullta;
 - 1.3. Mbledhje të jashtëzakonshme;
 - 1.4. Mbledhje urgjente;
 - 1.5. Mbledhje solemne.

Neni 10 Mbledhja inauguruese e kuvendit të komunës

1. Mbledhjen inauguruese të kuvendit të komunës e thërret kryetari i Komunës (aty ku është zgjedhur) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.
2. Ftesa për mbajtjen e mbledhjes inauguruese iu dërgohet shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes anëtarëve të kuvendit të komunës dhe autoritetit mbikëqyrës MPL-së.
3. Në raste të veçanta ftesa mund të dërgohet tre (3) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.
4. Nëse kryetari i komunës nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës në paragrafin I të këtij neni, mbledhja inauguruese e kuvendit të komunës thirret nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i kuvendit të komunës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data kur kryetari është dashur ta thirrë mbledhjen inauguruese të kuvendit të komunës.
5. Nëse anëtari më i vjetër i kuvendit nuk e thërret mbledhjen inauguruese të kuvendit të komunës, mbledhja thirret me iniciativën e shumicës së anëtarëve të zgjedhur të kuvendit të komunës.
6. Kryesimin e mbledhjes inauguruese dhe të gjitha mbledhjeve tjera të kuvendit deri në zgjedhjen e kryesuesit/es të kuvendit të Komunës e bënë anëtari më i vjetër i kuvendit të komunës që është i pranishëm në mbledhje.
7. Në mbledhje inauguruese në rend dite është vetëm dhënia e betimit të anëtarëve të kuvendit dhe kryetarit të komunës, si dhe zgjedhja e kryesuesit/es të kuvendit të komunës.
8. Dhënia e betimit të anëtarëve të kuvendit dhe kryetarit të komunës është akt solemn dhe duhet të nënshkruhet.
9. Kryetari i komunës pas certifikimit të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror Zgjedhor jep betimin para anëtarëve të kuvendit të komunës. Mungesa e kuorumit nuk ndikon në dhënien e betimit të kryetarit të komunës.
10. Kryetari i komunës e jep betimin ose deklaratën soleme para anëtarëve të kuvendit të komunës. Teksti i betimit është si në vijim:

“Betohe (ose deklaroj solemnisht) që do t’i kryej detyrat e mia dhe do t’i ushtroj kompetencat e mia si kryetar i komunës së Vushtrrisë me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t’i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë.”

11. Çdo anëtarë i kuvendit që merr pjesë në mbledhje duhet të shënojë emrin e tij/saj në librin e pjesëmarrësve ose në listën për personat prezent, destinuar për këtë qëllim.

Neni 11

Mbledhjet e rregullta të kuvendit/komiteteve obligative

1. Kuvendi i komunës/komitetet obligative duhet t'i mbajnë së paku dhjetë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, kurse pesë në gjashtëmujorin e dytë të vitit. Muaji gusht është muaj i pushimeve për kuvendin/komitetet e tij.
2. Mbledhjet e kuvendit të komunës mbahen të enjten e fundit të çdo muaji.
3. Kryesuesi/ja i/e kuvendit të komunës i thërret dhe i kryeson mbledhjet e kuvendit të komunës dhe mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa.
4. Në rast se kryesuesi/ja e thërret mbledhjen e kuvendit/KPF-së, por për shkaqe të caktuara mungon në mbledhje, atëherë mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i kuvendit/komitetit.
5. Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.
6. Në rastet kur mungon në mbledhje kryesuesi/ja i Komitetit për Komunitete, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i komitetit.

Neni 12

Mbledhjet e jashtëzakonshme të kuvendit të komunës

1. Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të komunës, caktohet me kërkesën e bërë me shkrim, nga më së paku 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës apo me kërkesë të kryetarit/es.
2. Kryesuesi/ja i Kuvendit të Komunës është i obliguar të thërret mbledhje të jashtëzakonshme sipas kërkesës së një të tretës (1/3) së anëtarëve të kuvendit të komunës apo me kërkesë të Kryetarit të Komunës.
3. E drejta për të thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme, gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar.
4. Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.
5. Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të komunës nuk mbahet nëse nukjanë të njoftuar me shkrim të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës dhe publiku, siç kërkohet

me Rregulloren e Punës së Kuvendit, së paku tri (3) ditë pune para datës të mbajtjes së takimit.

6. Procedurat e njëjta që kërkohen për njoftimin dhe çështjet tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, zbatohen për mbledhjet e jashtëzakonshme gjithashtu.

Neni 13

Mbledhjet urgjente të kuvendit të komunës

1. Kryesuesi/ja i kuvendit dhe kryetari i komunës, kanë të drejtë të thërrasin mbledhje urgjente të kuvendit të komunës.
2. Mbledhja urgjente e kuvendit të komunës, thirret në rast të fatkeqësive natyrore dhe rrethanave tjera urgjente në komunë.
3. Procedura për thirrjen e mbledhjes urgjente, nuk zbatohet si në rastet e thirrjes së mbledhjeve tjera të kuvendit të komunës.

Neni 14

Mbledhjet solemne të kuvendit të komunës

1. Mbledhja solemne thirret nga kryesuesi/ja i/e kuvendit të komunës dhe kryetari i komunës.
2. Mbledhja solemne mund të mbahet për raste të veçanta, festa shtetërore, festa zyrtare të komunës dhe solemnitete të tjera.
3. Mbledhja solemne thirret së paku një (1) ditë para mbajtjes së mbledhjes.

Neni 15

Komitetet e përhershme

1. Kuvendi i komunës themelon komitete të përhershme siç janë:
 - 1.1. Komiteti për Politikë dhe Financa, dhe
 - 1.2. Komiteti për Komunitete.

Neni 16

Komiteti për Politikë dhe Financa

1. Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet prej nëntë (9) anëtarëve.
2. Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të zgjedhen nga radha e anëtarëve të Kuvendit të komunës.

3. Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e komunës.
4. Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, marrjen e raporteve nga Kryetari, si dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e komunës.
5. Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor.
6. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera.
7. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa thirren dhe kryesohen nga Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të komunës. Në mungesë të Kryesuesit/es të Kuvendit të komunës, mbledhja kryesohet nga anëtari/ja më i/e vjetër i/e komitetit.
8. Ftesa për mbledhje duhet t'u dërgohet anëtarëve shtatë ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.

Neni 17 **Komiteti për Komunitete**

1. Komiteti për Komunitete mund t'i ketë nëntë (9) anëtarë.
2. Anëtarët e Komitetit për Komunitete, zgjedhen nga Kuvendi i komunës nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të komunës dhe përfaqësuesve të komuniteteve pakicë.
3. Komunitetet pakicë në komunë, duhet të kenë përfaqësimin e paraparë me ligjin në fuqi në Komitetin për Komunitete.
4. Përbërja e Komitetit për Komunitete duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor.
5. Komiteti për Komunitete përfshin në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë, përfaqësohet nga së paku një (1) përfaqësues në Komitetin për Komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të Komitetit të Komuniteteve.
6. Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë

të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

7. Ftesa për mbledhje duhet t'u dërgohet anëtarëve shtatë ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.

Neni 18

Themelimi i komiteteve tjera

1. Kuvendi i Komunës varësisht nga nevoja për kryerjen e përgjegjësisve në sektor të caktuar mund të themeloj komitete tjera.
2. Këto komitete mund të themelohen në fusha të ndryshme si në: zhvillim ekonomik, në shërbime publike, barazi gjinore, planifikim urban, kadastër, pronë, në mbrojtje të ambientit, arsim, kulturë, rini, sport, shëndetësi, mirëqenie sociale dhe në fusha të ndryshme ku komuna e sheh të nevojshme.
3. Kuvendi i komunës mund të themelojë komitete konsultative me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Neni 19

Kryesuesi/ja i/e kuvendit të komunës

1. Kuvendi i komunës e zgjedh kryesuesin/en e Kuvendit të komunës nga radhët e anëtarëve, me mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të komunës. Propozimlista për kryesues/e të Kuvendit të komunës duhet të ketë një e më shumë kandidatë/e të mundshëm/e për t'u zgjedhur Kryesues/e i/e Kuvendit të komunës.
2. Kuvendi i komunës me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Kuvendit të komunës, formon komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit për Kryesuesin/en e Kuvendit, i cili/a përbëhet nga 3 deri në 5 anëtarë të Kuvendit të komunës.
3. Komisioni për votim është përgjegjës që të numërojë votat dhe t'i komunikojë rezultatet e votimit para anëtarëve të Kuvendit të komunës.
4. Votimi për kryesues/se të kuvendit të komunës bëhet me vota të fshehta. Për t'u zgjedhur në votimin e parë, kandidati i propozuar si kryesues/e i/e kuvendit, duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.
5. Në rast se, në votimin e parë asnjëri/ra prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur, do të zgjedhet Kryesues/se i/e Kuvendit të komunës.

6. Nëse edhe pas votimit të dytë, asnjëri/ra nga kandidatët/et nuk e ka fituar shumicën e kërkuar të votave si në paragrafin 3 të këtij neni, shkohet në votimin e tretë. Në votimin e tretë kryesues/ja i/e Kuvendit të komunës, zgjedhet kandidati/ja, i/e cili/a merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse edhe pas votimit të tretë nuk zgjedhet kryesuesi/ja i/e kuvendit të komunës, atëherë i tërë procesi i votimit përsëritet me propozimin e kandidatëve tjerë për kryesues/e të kuvendit. Kur procesi i zgjedhjes bëhet me votim të fshehur, nuk ka vota të abstenuara, kurse votat e pavlefshme llogariten pjesëmarrje në votim.

Neni 20 **Kompensimi**

1. Anëtarët e Kuvendit të Komunës, komiteteve të përhershme, komiteteve tjera, komisioneve, grupeve punuese, për punën e tyre kompensohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 21 **Kompetencat e Kryesuesit/es të kuvendit të komunës**

1. Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të komunës i thërret dhe i kryeson mbledhjet e kuvendit dhe KPF-së.
2. Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të komunës i nënshkruan të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i komunës dhe është i/e obliguar të kujdeset për procedimin e tyre, ndërkaq një kopje të aktit të nënshkruar ia dorëzon Kryetarit/es të komunës dhe organeve përgjegjëse për zbatim.
3. Kryesuesi/ja mund të jap sqarime apo përgjigje dhe opinionin e tij lidhur me çështjen në diskutim, duke orientuar diskutimin rreth pikës së rendit të ditës, propozimeve të anëtarëve të kuvendit, para përfundimit të diskutimit dhe marrjes së vendimit për propozimin për çështjen në diskutim.
4. Kryesuesi/ja i/e kuvendit kujdeset për mbarëvajtjen e procesit të diskutimeve në kuvend dhe për krijimin e kushteve normale për diskutim dhe propozime nga anëtarët e kuvendit dhe merr masa adekuate ndaj anëtarëve të kuvendit që eventualisht me ndrëhyrje apo forma tjera e pengojnë këtë proces.
5. Gjatë tërë kohëzgjatjes së mbledhjes, kryesuesi/ja duhet ta respektojë parimin që të gjithë anëtarët pjesëmarrës dhe me të drejtë fjalimi të gëzojnë të drejtën e barabartë dhe të kenë rastin që të marrin pjesë aktivisht në mbledhje.

Neni 22 **Shkarkimi i Kryesuesit/es të kuvendit të komunës**

1. Kryesuesi/ja i/e Kuvendit mund të shkarkohet me votat e më tepër se 50% plus një votë, të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit.

2. Kërkesën për shkarkim të Kryesuesit/es të Kuvendit të komunës mund ta bëjë me shkrim dhe nënshkrimet e së paku një të tretat (1/3) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të komunës, së paku dhjetë (10) ditë para mbajtjes të mbledhjes së rregullt.
3. Lidhur me shqyrtimin e kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni, vendos Kuvendi i komunës me shumicën e votave të anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit.
4. Votimi për shkarkimin e Kryesuesit/es bëhet me votim të fshehtë.

Neni 23

Pjesëmarrja në mbledhjet e kuvendit

1. Sekretaria e kuvendit duhet të sigurojë kushte të nevojshme për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit.
2. Secili anëtar i kuvendit është i obliguar të marrë pjesë në mbledhje të kuvendit. Në rast të pamundësisë së ardhjes në mbledhje, duhet ta njoftojë pa vonesë kryesuesin/en e kuvendit. Mospjesëmarrja në mbledhje duhet të konstatohet në procesverbal.
3. Kuvendi i komunës përkatësisht organi kompetent i administratës do t'ua lehtësojë pjesëmarrjen e anëtarëve të kuvendit me aftësi të kufizuara dhe sigurojë çfarëdo ndihme teknike për këtë qëllim.

Neni 24

Ftesat, rendi i ditës dhe materialet për mbledhjet e kuvendit/KPF-së

1. Kryesuesi/ja i/e kuvendit përmes sekretarisë ju dërgon ftesën me shkrim për pjesëmarrje në mbledhje secilit anëtarë të kuvendit/KPF-së. Në ftesë shënohet data, vendi, koha, si dhe rendi i ditës së mbledhjes.
2. Materialet e mbledhjes së kuvendit, anëtarëve të kuvendit iu dërgohen 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së kuvendit në formë elektronike, si dhe në formë fizike deri në sigurimin e pajisjeve elektronike (laptop ose tablet).
3. Kryesuesi/ja i/e kuvendit/KPF-së përmes zyrtarit për informim duhet të publikojë njoftimin për kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të komunës.

Neni 25

Pajisja me kartelë të identifikimit dhe adresa elektronike për anëtarët e kuvendit

1. Anëtarët e kuvendit pajisen me kartelë identifikimi më së largu 30 ditë pas verifikimit të mandatit të tyre.
2. Anëtarët e kuvendit janë të obliguar që në rastin e pjesëmarrjes në mbledhjet e kuvendit ta bartin kartelën e identifikimit dhe atë duke e mbajtur në vend të dukshëm.
3. Kartelat e identifikimit ua siguron organi kompetent i administratës së komunës.
4. Kryesuesi/ja dhe anëtarët e kuvendit duhet të pajisen brenda një muaji nga verifikimi i mandatit të tyre me adresa elektronike zyrtare, të cilat duhet të përdoren për komunikim zyrtar.
5. Adresat elektronike zyrtare të tyre duhet të publikohen në faqen zyrtare të komunës.
6. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë e ka për obligim që t'ua sigurojë pajisjet elektronike (laptop ose tablet) dhe pajisje tjera të nevojshme për kryerjen sa më efikase të punëve të kuvendit.
7. Anëtarët e kuvendit janë të obliguar që në mbledhjet e kuvendit t'i shfrytëzojnë pajisjet elektronike të siguruar nga komuna.

Neni 26

Kuorumi

Mbledhjet e kuvendit mund të mbahen nëse në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të kuvendit **(50% + 1)**.

Neni 27

Mbledhjet jashtë sallës së kuvendit të komunës

Kuvendi i komunës mund të mbajë mbledhje në lokacion (sallë) tjetër, nëse për këtë pajtohen paraprakisht kryesuesi/ja i kuvendit dhe kryetari i komunës.

Neni 28

Ulja në sallë e anëtarëve të kuvendit dhe pjesëmarrësve tjerë

1. Ulja në sallë rregullohet në fillim të mandatit, në pajtim me përfaqësuesit e subjekteve politike, duke i dhënë përparësi në zgjedhje subjektit politik që ka fituar më së shumti ulëse në KK.
2. Kryetari dhe nënkryetari i komunës ulen në ulëset e dedikuara si vende të veçanta për të njëjtit.

3. Drejtorët e drejtorive komunale ulen në rendet pas anëtarëve të kuvendit, apo në ulëset e dedikuara si vende të veçanta për të njëjtit.
4. Stafi i Sekretarisë së Kuvendit ulet në një vend të përshtatshëm, ku mund të shihen të gjithë anëtarët e kuvendit.
5. Pjesëmarrësit tjerë (përfaqësuesit e shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare, mediave, qytetarët etj) ulen në ulëset e radhës apo në vendet që iu janë dedikuar.

Neni 29

Pjesëmarrja e publikut dhe mediave në mbledhjen e kuvendit/komiteteve obligative

1. Mbledhjet e kuvendit dhe komiteteve janë publike, përveç rasteve kur kuvendi/komiteti me votën e shumicës merr vendim për përjashtimin e publikut dhe mediave nga mbledhja e kuvendit/komitetit apo një pjesë të tij, si:
 - 1.1. Nëse vlerësohet se pjesëmarrja e publikut dhe mediave në mbledhje mund të shkaktojë çrregullim publik apo dhunë;
 - 1.2. Dyshohet se do të zbulojë informacione dhe dokumente të cilat janë të klasifikuara si të besueshme, sipas Ligjit mbi Qasjen në Dokumentet Publike;
 - 1.3. Dyshohet (se mund) të zbulojë informacione të ndjeshme personale;
 - 1.4. Zbulohen informacione lidhur me procedurat gjyqësore të tanishme apo të ardhshme;
 - 1.5. Në raste të tilla, kryesuesi/ja i/e kuvendit/komitetit njofton publikun dhe mediat për arsyet dhe vendimin e marrë;
2. Pjesëtarët e publikut mund të marrin fjalën në mbledhje të kuvendit, me kusht që para fillimit të punimeve të mbledhjes së kuvendit të parashtrahet kërkesë me shkrim te kryesuesi/ja i/e kuvendit, duke specifikuar çështjen për të cilën kërkojnë të shqyrtohet. Atij/asaj do t'i lejohet të diskutojë për çështjen, jo më tepër se pesë minuta. Në raste të caktuara kryesuesi/ja i/e mbledhjes mund të lejojë të diskutojë edhe dy minuta tjerë, por duhet ta ndërpres atë nëse tejkalon kohën shtesë të lejuar ose nuk i përmbahet çështjes për të cilën e ka marrë fjalën.

Neni 30

Shqyrtimi paraprak i propozimeve të ndryshme

1. Para se të paraqiten në kuvend, çështjet duhet të shqyrtohen nga kryetari i komunës dhe Komiteti për Politikë dhe Financa.
2. Në raste urgjente kryesuesi/ja i/e kuvendit në bashkëpunim me kryetarin e komunës mund të procedojnë materiale për pika shtesë të rendit të ditës, të cilat nuk kanë kaluar përmes Komitetit për Politikë dhe Financa.
3. Anëtarët e kuvendit mund të propozojnë që një apo më shumë pika t'i shtohen apo t'i hiqen rendit të ditës ose të ndryshohet renditja.

4. Nëse kryesuesi/ja i/e mbledhjes vlerëson se për propozimet e paraqitura (nga anëtarët e kuvendit) ka nevojë për përgatitje të duhur nga qeveria komunale, propozimet në fjalë nuk votohen.

Neni 31

Përgatitja dhe shqyrtimi i propozimeve nga ana e kuvendit të komunës, e drejta e inicimit dhe propozimit

1. Materialet për kuvendin e komunës, përgatitën dhe propozohen kryesisht nga:
 - 1.1. Ekzekutivi i Komunës — Kryetari i Komunës;
 - 1.2. Drejtoritë komunale;
 - 1.3. Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të Komunës;
 - 1.4. Komitetet e Kuvendit të Komunës;
 - 1.5. Anëtarët e Kuvendit të Komunës;
 - 1.6. Pesëmbëdhjetë për qind (15%) e qytetarëve me të drejtë vote, si dhe nga subjektet e tjera të parapara me ligj, udhëzime dhe rregullore.
2. Propozimet kryesisht hartohen sipas Planit të punës së kuvendit për vitin vijues, në periudha të caktuara kohore për shqyrtim sipas planifikimit, apo edhe mund të hartohen dhe procedohen edhe propozime të tjera të paplanifikuara me plane pune, por që vlerësohen si të domosdoshme për shqyrtim nga ekzekutivi komunal apo institucionet tjera kompetente.
3. Propozuesit obligohen që propozimet për shqyrtim t'i hartojnë në bazë të ligjeve, statutit, rregulloreve dhe akteve tjera nënligjore në fuqi. Propozimi duhet të përmbajë:
 - 3.1. Propozimin për shqyrtim në kuvend të komunës, duhet të jetë me shkrim, i protokoluar dhe i nënshkruar nga personi përgjegjës me arsyetim përkatës për shqyrtim dhe vendosje, si dhe duhet të ketë të bashkëngjitur konkluzionin, me propozim të kryetarit të komunës për kuvendin;
 - 3.2. Propozimit duhet bashkëngjitur edhe Draft — Vendimi që propozuesi ja propozon kuvendit të komunës për miratim me bazën ligjore për këtë;
 - 3.3. Aktet që procedohen për shqyrtim në kuvend të komunës, duhet të jenë të përkthyer në gjuhë zyrtare, të protokoluara, si dhe të kompletuara me dokumente të nevojshme procedohen për kuvendin e komunës përmes sekretarisë.
 - 3.4. Nëse kemi të bëjmë me akt normativ, duhet të bashkëngjitet Draft- akti normativ, që duhet të jetë i qartë, konsistent, koherent, i kuptueshëm, i qasshëm për të gjithë, i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe statut të komunës me formë dhe përmbajtje të qartë, si dhe duhet t'i plotësojë kushtet e tjera të përcaktuara me dispozita ligjore në fuqi;

3.5. Aktet hartohen nga zyrtari përgjegjës apo komisioni i formuar nga propozuesi - hartuesi i aktit (drejtoria apo institucioni tjetër kompetent);

3.6. Aktet, para se të procedohen në kuvend duhet t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik, ku procedurën e konsultimit publik e organizon dhe zbaton propozuesi i aktit (zyrtari apo komisioni), duke paraqitur në fund raportin mbi rrjedhën e konsultimit publik, vërejtjet dhe sugjerimet e paraqitura në draft, cilat janë implementuar dhe cilat jo me arsyetimin e mospërfshirjes së tyre, gjithnjë duke u batuar në legjislacionin në fuqi që rregullon çështjen në fjalë. Në fund e paraqet për miratim në kuvend;

4. Aktet e miratuara nga kuvendi i komunës duhet të hartohen në gjuhë zyrtare nga Sekretaria e kuvendit.
5. Aktet e miratuara nga kuvendi i komunës i nënshtrohen procedurës së shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, përpos akteve të cilat me Udhëzim Administrativ të MPL- së janë përjashtuar nga ky proces.
6. Aktet pas konfirmimit të ligjshmërisë së tyre publikohen në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Neni 32 **Peticioni**

1. Secili person fizik dhe juridik apo organizatë që ka interes në komunë, ka të drejtë t'i paraqes petition Kuvendit të komunës, për cilëndo çështje që lidhet me punën e komunës. Peticioni është kërkesë për Kuvendin, për t'u marrë me çështjet specifike, apo për të miratuar rregullore dhe vendime të caktuara dhe përbën një të drejtë themelore demokratike.
2. Kuvendi i komunës duhet të njohë rëndësinë e petitionit dhe t'i përgjigjet të gjitha pyetjeve dhe kërkesave të përfshira në petition. Peticioni mund të rezultojë gjithashtu me mbajtjen e takimit publik, në të cilin popullata diskuton për çështjet me interes për ta, bashkë me zyrtarët komunal.
3. Të gjitha petitionet mund t'i drejtohen Kuvendit të komunës, Kryetarit/es të komunës, Kryesuesit/es të Kuvendit, komiteteve të Kuvendit apo drejtorive komunale, drejtpërsëdrejti, nëpërmjet postës elektronike ose të shkruar.
4. Kuvendi i komunës nuk do të ketë parasysh asnjë petition që ka të bëjë me çështje që nuk janë kompetencë dhe përgjegjësi e komunës dhe organeve të saj.
5. Secili petition duhet të përmbajë emrin dhe adresën e organizatorit, emrat, numrin e letërnjoftimit dhe adresat e personave që e nënshkruajnë. Lënda e petitionit duhet të shënohet qartë në çdo faqe të petitionit/ankesës.

6. Kryesuesi/sja i/e Kuvendit në koordinim me Kryetarin/en i/e komunës, do të paraqes çdo petition para Kuvendit të komunës brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita që pranon petitionin, gjegjësisht në takimin e ardhshëm të radhës të Kuvendit të komunës, nëse në afatin e caktuar nuk është shqyrtuar i njëjti.

Neni 33 **Përgjigje në petition**

1. Kuvendi i komunës do të marrë një vendim përfundimtar lidhur me lëndën e petitionit më së largu tridhjetë (30) ditë pasi të bëhet prezentimi i petitionit në Kuvendin e komunës.
2. Vendimi do të arsyetohet dhe do t'i komunikohet me shkrim organizatorit të petitionit.

Neni 34 **Iniciativa qytetare**

Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar projekt-rregullore brenda kompetencave të komunës, për miratim nga Kuvendi i komunës apo me votën e qytetarëve në pajtim me ligjin.

Neni 35 **Deklarimet jashtë rendit të ditës**

1. Para miratimit të rendit të ditës, anëtarët e kuvendit mund të diskutojnë për çështje që nuk janë të parapara në rendin e ditës, por që janë të rëndësishme dhe me interes për komunën.
2. Anëtarët e kuvendit nuk kanë të drejtë të diskutojnë për të njëjtën çështje apo për të njëjtin propozim.
3. Në rastet e këtilla, një anëtar i kuvendit mund të diskutojë deri në 3 minuta, ndërsa nëse diskutohet në emër të grupit kuvendar mund të flas deri në 5 minuta.
4. Kur diskutimet zgjasin më tepër se koha e caktuar, kryesuesi/ja i/e mbledhjes ndërpre diskutimet.
5. Për deklaratimet e anëtarëve të kuvendit nuk ka replikë.
6. Pas përfundimit të deklaratimeve të anëtarëve të kuvendit jashtë rendit të ditës, anëtarët e qeverisë komunale, mund të deklarohen për ndonjë çështje ose sqarim që është ngritur nga anëtari/ja i/e kuvendit jashtë rendit të ditës, si dhe çështje që kanë të bëjnë me fushëveprimin dhe përgjegjësitë e tyre.
7. Pas deklaratimit të anëtarit/es të qeverisë komunale, mund të deklarohet edhe anëtari/ja i/e kuvendit që ka parashtruar çështjen.

8. Deklarimi i anëtarit/es të qeverisë komunale mund të zgjasë deri në tre (3) minuta. Ndërsa, deklarimi i anëtarit/es të kuvendit për çështjen e ngritur mund të zgjasë deri në dy (2) minuta.
9. Koha e caktuar për deklarime jashtë rendit të ditës kufizohet deri në katërdhjetë (40) minuta.

Neni 36

Rendi i punës deri në miratimin e rendit të ditës

1. Kuvendi i komunës do të punojë sipas këtij rendi të punës:
 - 1.1. Konstatimi i kuorunit;
 - 1.2. Prezantimi i pjesëmarrësve tjerë në mbledhje;
 - 1.3. Njoftimi i anëtarëve të kuvendit për pjesëmarrjen e publikut;
 - 1.4. Propozimet për pika shtesë, heqjen eventuale të ndonjë pike të rendit të ditës, si dhe ndryshimin e renditjes së pikave ekzistuese;
 - 1.5. Miratimi i rendit të ditës;
 - 1.6. Pikat e rendit të ditës nuk mund të shtohen e as të ndryshohen pas aprovimit të rendit të ditës.

Neni 37

Rregullat e debatit

1. Anëtarët e kuvendit mund të diskutojnë për pikat e rendit të ditës në bazë të renditjes së paraqitur për diskutim. Fjala e tyre duhet të dëgjohet deri në përfundimin e diskutimit dhe nuk lejohet ndërhyrja gjatë diskutimeve.
2. Diskutimet e anëtarëve të kuvendit mund të zgjasin 5 minuta me përjashtim të referuesve të materialeve dhe udhëheqësve të grupeve kuvendare.
3. Askush nuk ka të drejtë të diskutojë më tepër se një herë për të njëjtën çështje, me përjashtim të sqarimeve plotësuese nëse kërkohen.
4. Në replikë ka të drejtë vetëm anëtari/ja i/e kuvendit, të cilit i përmendet emri (në kontekst të diskutimit apo propozimit që është objekt shqyrtimi), replika zgjat më së shumti 1 minutë.
5. Nëse dy ose më shumë anëtarë dëshirojnë të marrin fjalën në të njëjtën kohë, kryesuesi/ja i/e mbledhjes vendos për renditjen e dhënies së fjalës.

6. Në rastin e diskutimit, anëtari/ja i/e kuvendit është i obliguar të dalë në foltoren e sallës së kuvendit. Një gjë e tillë nuk do të vlejë, nëse salla e kuvendit pajiset me mikrofonta nëpër ulëset e anëtarëve të kuvendit.

7. Nëse ndonjë anëtar jep ndonjë propozim, kërkesë apo pyetje, ai ka të drejtë të marrë përgjigjen nëse është e mundur menjëherë gjatë mbledhjes, apo më së largu deri në fillim të mbledhjes së radhës së KK-së.

8. Kur një propozim i dhënë është duke u diskutuar, nuk lejohet bërja e propozimeve tjera, përveç:

8.1. Propozimi i bërë për të parandaluar çrregullimet;

8.2. Propozimi për të përjashtuar publikun dhe shtypin;

8.3. Propozimi për të kaluar në pikën e radhës të rendit të ditës;

8.4. Propozimi që kërkon që çështja në diskutim të mbyllet në mbledhje me marrjen e vendimit;

8.5. Propozimi për të shtyrë diskutimin e çështjes së shtruar për mbledhjen e ardhshme,

8.6. Propozimi për ndërprerjen e mbledhjes;

9. Kryesuesi/ja nuk do të lejojë asnjë propozim sipas nënparagrafit 8.3. ose 8.4. të kësaj rregulloreje gjatë mbledhjes, derisa të gjithë që dëshirojnë të marrin fjalën ta kenë bërë këtë për kohën e paraparë.

Neni 38

Pyetjet e anëtarëve të kuvendit

1. Pyetjet eventuale nga anëtarët e kuvendit të parashtrihen si pikë e fundit e rendit të ditës, për të cilat duhet të ketë përgjigje me shkrim në mbledhjen e radhës së KK-së;

2. Për pyetjet e parashtruara nga anëtarët e kuvendit, për të cilat jepet përgjigje verbale aty për aty, nuk ka nevojë që për të njëjtat të jepet përgjigje me shkrim.

Neni 39

Grupet Kuvendare

1. Grupet kuvendare, pjesëmarrëse në kuvend caktojnë udhëheqësit e grupeve të tyre. Grupi kuvendar njofton me shkrim kryesuesin/en dhe sekretarinë e kuvendit për emrin e udhëheqësit të atij grupi.

2. Udhëheqësit e grupeve, përkatësisht të autorizuarit e tyre, si dhe anëtarët në mënyrë individuale, kanë të drejtë të kërkojnë pauza për konsultime gjatë mbledhjes së kuvendit të komunës, si dhe ndërprerjen e mbledhjes duke paraqitur arsyet për ndërprerje.

3. Lidhur me kërkesën për pauzë apo për ndërprerje vendos kryesuesi/ja i/e kuvendit të komunës pas konsultimit me anëtarët e kuvendit.

Neni 40

Votimi

1. Në mbledhjet e kuvendit/komiteteve vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve prezent, nëse nuk parashihet ndryshe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës.
2. Prania e anëtarëve në mbledhje verifikohet me sistem elektronik, me numërim fizik ose me thirrje të emrave. Për mënyrën e verifikimit të pranisë së anëtarëve, vendos kryesuesi/ja i/e seancës.
3. Aktet e kuvendit janë të vlefshme, nëse në votim marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të kuvendit. Përgjashtim bëjnë rastet kur me ndonjë ligj tjetër apo me statut parashihet ndryshe.
4. Votimi bëhet në mënyrë të hapur ose të fshehtë:
 - 4.1. Votimi i hapur bëhet në mënyrë elektronike ose me ngritje të dorës;
 - 4.2. Votimi i fshehtë bëhet me fletëvotime, duke e thirrur secilin anëtarë të kuvendit veç e veç.
5. Fletëvotimi i fshehtë, me një kandidat, duhet të përmbajë të paktën objektin e votimit dhe alternativat e votimit “për”, “kundër” dhe “abstenim”. Në fletën e votimit anëtari/ja i/e kuvendit shënon **me një shenjë të dallueshme dhe të qartë zgjedhjen e bërë në alternativën për të cilën voton**. Në rast se fleta e votimit përmban më shumë se një kandidat, anëtari/ja i/e kuvendit vendos shenjën për zgjedhjen e bërë përbri emrave të vendosur në kuadrat.
6. Çdo votim është i regjistruar, përpos votimit të fshehtë. Vota e secilit anëtar të kuvendit “për”, “kundër” ose “abstenim” regjistrohet me emër e me mbiemër. Kur votimi bëhet në mënyrë elektronike, në ekran paraqitet numri i pjesëmarrësve, numri i votuesve dhe rezultati i plotë i votimit.
7. Në rastet kur nuk janë prezent në punimet e kuvendit (sallë) një numër i konsideruar i anëtarëve të kuvendit, para votimit duhet të konstatohet kuorumi.
8. Në rast se votimi është i barabartë, vota e kryesuesit/es të kuvendit është vendimtare.
9. Kur ka nevojë të bëhet votimi i fshehtë mbi propozimin për emërtimin ose zgjedhjen e ndonjë anëtari/es për pozitën, e cila duhet të vendoset nga kuvendi i komunës dhe kur ekzistojnë dy ose më shumë kandidatë të propozuar për pozitën në fjalë, emrat e të gjithë të propozuarve paraqiten sipas radhitjes alfabetike të emrave dhe mbiemrave të tyre.
10. Kur ka nevojë të bëhet votimi i fshehtë për propozimin si në paragrafin 5 të kësaj rregulloreje, Sekretaria e Kuvendit duhet të përgatit fletëvotimet dhe të sigurojë

kutinë për votim. Çdo fletëvotim përmban emrat e të gjithë kandidatëve të renditur në mënyrë alfabetike, bazuar në emrat dhe mbiemrat e tyre.

11. Me shumicën e votave të anëtarëve prezent të kuvendit, do të formohet komisioni për përcjelljen e zbatimit të votimeve, në përbërje prej tre deri pesë anëtarë.
12. Sekretaria e kuvendit do t'ia dorëzojë komisionit për përcjelljen e zbatimit të votimit listën me emrin/at e kandidatëve të propozuar.
13. Kryesuesi/ja i/e mbledhjes do t'i thërras për të votuar një nga një të gjithë anëtarët e kuvendit.
14. Komisioni për përcjelljen e zbatimit të votimit i numëron publikisht votat në mbledhje menjëherë pas mbylljes së votimit dhe ia prezanton kryesuesit/es të mbledhjes, i cili i deklaron publikisht rezultatet e votimit.
15. Sekretaria e Kuvendit duhet t'i mbajë fletëvotimet në vend të sigurt dhe t'i ruajë deri në 1 vit, nga dita e mbajtjes së votimit.

Neni 41

Procesverbali dhe incizimi

1. Për të gjitha mbledhjet e kuvendit/komiteteve mbahet procesverbali. Procesverbalin e mban zyrtari i sekretarisë. Në procesverbal shënohet: data, koha dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes, pjesëmarrja përkatësisht mungesat në mbledhje të anëtarëve të kuvendit/komiteteve, pjesëmarrësve tjerë, rendi i ditës, esenca e diskutimit, mënyra e votimit dhe vendimet të cilat merren në mbledhje.
2. Secili anëtar mund të kërkojë që procesmbajtësi të shënojë se si ai/ajo ka votuar për çështjen e caktuar në mbledhje ose nëse ai /ajo ka abstenuar.
3. Procesverbali shqyrtohet dhe aprovohet në mbledhje të radhës së kuvendit/komiteteve.
4. Përjashtimisht në raste të pengesave objektive, procesverbali mund të aprovohet në mbledhjen tjetër të radhës.
5. Në rastet kur kryesuesi/ja i mbledhjes kërkon nga anëtari/ja i/e kuvendit që ta përfundojë diskutimin, ndërsa nuk respektohet kërkesa e kryesuesit/es, diskutimi i mëtejshëm nuk përfshihet në procesverbal.
6. Procesverbali arkivohet, publikohet (në faqen zyrtare të komunës) dhe ruhet konform dispozitave ligjore.
7. Video ose audio – incizimi publikohet në faqen zyrtare të komunës.
8. Kryesuesi/ja i/e mbledhjes dhe procesmbajtësi duhet ta nënshkruajnë procesverbalin pas aprovimit të tij.

Neni 42
Shpërndarja e kuvendit jofunksionues të komunës

1. Nëse kuvendi i komunës dështon në kryerjen e funksionit të detyrueshëm sipas standardeve të përcaktuara me ligj, apo nëse bëhet jofunksional dhe kështu rrezikon ushtrimin e të drejtave themelore të qytetarëve, ministria përgjegjëse për qeverisje lokale njofton komunën për dështimin dhe kërkon që të ndërmerren masa të duhura në mënyrë që të sigurohet kryerje e qetë e funksionit komunal.
2. Kuvendi i Komunës konsiderohet jo funksionues nëse:
 - 2.1. Nuk e zgjedh kryesuesin/es, tridhjetë (30) ditë pas themelimit;
 - 2.2. Nuk miraton statutin e saj brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas themelimit;
 - 2.3. Nuk miraton buxhetin sipas afatit të paraparë me ligjin përkatës; ose
 - 2.4. Nuk mban mbledhje për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj;
3. Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale e njofton Qeverinë e Republikës së Kosovës për mosfunksionimin e komunës. Qeveria mund ta shpërndajë kuvendin e komunës jofunksionues.
4. Zgjedhjet e reja për kuvendin e komunës mbahen në pajtim me ligjin për zgjedhjet komunale.

Neni 43
Rregullat e mirësjelljes

1. Nëse kryesuesi/ja i/e mbledhjes konsideron se ndonjëri prej anëtarëve nuk sillet mirë në mbledhje duke e penguar punën e mbledhjes me dashje ose duke u sjell në mënyrë ofenduese, atij i tërhiqet vërejtja. Nëse sjelljet e anëtarit/es në fjalë vazhdojnë të jenë të pandryshuara, kryesuesi/ja i/e mbledhjes mund të ndërmarrë ndonjërin prej masave në vijim:
 - 1.1. Kërkon që të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga pjesa e mbetur e mbledhjes, përveç kur do të ketë votim;
 - 1.2. Ndërpret mbledhjen e kuvendit për një kohë të caktuar ose e shtyn mbledhjen për ndonjë ditë tjetër;
 - 1.3. Nëse përdoret gjuhë joparlamentare nga anëtarët e kuvendit dhe pjesëmarrësit tjerë, kryesuesi/ja fillimisht ua tërheq vërejtjen dhe kërkon që ta tërheq fjalën. Nëse edhe pas tërheqjes së vërejtjes vazhdon me të njëjtën gjuhë, atëherë kryesuesi/ja kërkon që ta lirojë sallën e kuvendit;
 - 1.4. Në rastet kur gjatë punimeve të kuvendit shkaktohet dhunë nga kushdo qoftë në sallë apo në ambientet e sallës së kuvendit, kryesuesi/ja i/e mbledhjes ndërpret punimet dhe në rastet e nevojshme lajmërohet sigurimi i komunës dhe policia.

Neni 44
Shtyrja e mbledhjes së kuvendit

1. Mbledhja e caktuar e kuvendit mund të shtyhet nëse paraqiten shkaqet (rrethanat) të cilat janë të arsyeshme për të mos mbajtur mbledhjen e caktuar. Për shtyrjen e kësaj mbledhjeje vendos kryesuesi/ja i/e kuvendit në bashkëpunim me kryetarin e komunës.
2. Kryesuesi/ja i/e kuvendit njofton anëtarët e kuvendit për arsyet e shtyrjes së mbledhjes, më së voni një ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes, si dhe për datën dhe orën e mbajtjes së mbledhjes së shtyrë.

Neni 45
Ndërprerja e mbledhjes së kuvendit

1. Mbledhja e kuvendit ndërpritet në këto raste:
 - 1.1. Me qëllim të pushimit gjatë mbledhjes (pauzës);
 - 1.2. Kur gjatë mbledhjes numri i anëtarëve të kuvendit bie nën numrin e paraparë për mbajtje të mbledhjes dhe marrje të vendimeve;
 - 1.3. Kur për shkak të qëndrimit të gjatë në mbledhje dhe lodhjes së anëtarëve të kuvendit;
 - 1.4. Mbledhja e ndërprerë vazhdohet me të njëjtin rend dite në ditën e nesërme, nëse nuk është ditë pushimi apo në ditën të cilën e cakton kryesuesi/ja i/e kuvendit.

Neni 46
Përdorimi i gjuhëve në mbledhjet e kuvendit/komiteteve

1. Mbledhjet e kuvendit/komiteteve mbahen në gjuhët zyrtare të komunës, duke siguruar përkthimin adekuat.
2. Me kërkesë të anëtarit/es të kuvendit nga radha e komunitetit, gjuha amtare e të cilit është në përdorim zyrtar në komunë, duhet të sigurohet përkthimi në gjuhën e tij në mbledhje të kuvendit.

Neni 47
Dispozitat përfundimtare

1. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale të kësaj rregulloreje bëhen sipas procedurës së miratimit të së njëjtës në kuvendin e komunës.
2. Procedurën për ndryshimin, plotësimin apo draftimin e rregullores së re mund ta iniciojë kryesuesi/ja i/e kuvendit në konsultim me grupet kuvendare të komunës.
3. Procedurën për ndryshimin, plotësimin apo draftimin e rregullores së re mund ta iniciojnë së paku një e treta (1/3) e anëtarëve të kuvendit.
4. Vendimin për ndryshim/plotësimin e rregullores e merr kuvendi me shumicën e vota të anëtarëve të kuvendit.

Neni 48
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen dispozitat e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, 01 Nr.71/13, datë 04.04.2013.

Neni 49
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 50

Në rast se ekziston konflikti në mes të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (LVL), ose Statutit të Komunës së Vushtrrisë, atëherë vlejné dispozitat e LVL-së, përkatësisht të Statutit.

Melihate Basholli Latifi

Kryesuese e Kuvendit

